

INFORMACION PËR VEPRIMET ME LETRAT ME VLERË TË APLIKUARA NGA FIBANK

1. FIBank ofron mundësinë e pjesëmarrjes së individëve dhe jo individëve në ankandet e tregut primar të Bonove dhe Obligacioneve të Thesarit (organizuar nga Banka e Shqipërisë) nëpërmjet të gjitha sporteleve të bankës.

Komisioni i aplikuar nga FIBank për të vepruar në rolin e ndërmjetësit në ankand është :

- Në ALL: 0.15% e vlerës nominale, minimumi ALL 1,000, maksimumi ALL 5,000;
- Në EUR: 0.15% e vlerës nominale, minimumi EUR 10, maksimumi EUR 40.

2. FIBank tregton Bono Thesari nga disa ankande me afate maturimi të ndryshme.

a) FIBank shet Bono Thesari nga disa ankande me afate maturimi të ndryshme.

Kur klienti blen Bono të Thesarit nga portofoli i tregtueshëm i bankës, FIBank nuk aplikon asnjë komision. Në këtë rast klienti do të paguajë shumën në bazë të çmimit të shitjes së kuotuar nga banka dhe ditëve të mbetura deri në maturim.

Shembull:

Një klient dëshiron të blejë një Bono Thesari në një shumë LEK 1,000,000 nga portofoli i FIBank të cilës i kanë mbetur 273 ditë deri në maturim.

Yield-i i shitjes nga FIBank është 6.60%.

Çmimi i shitjes = $1,000,000 * C / (6.60 + C)$

C - konstante e cila llogaritet $365 * 100 / 273$

Çmimi = $(1,000,000 * 133.7) / (6.60 + 133.7) = 952,957.82$

b) FIBank blen Bono Thesari të cilat mund të jenë shitur në ankandet e tregut primar, nga portofoli i Fibank , ose nga portofoli i një banke tjetër të licencuar nga AMF si broker.

Kur klienti shet Bono të Thesarit para datës së maturimit pranë sporteleve të Fibank, nuk aplikohet asnjë komision. Në këtë rast klientit i llogaritet çmimi në bazë të yield-it të blerjes nga banka dhe ditëve të mbetura deri në maturim.

Çmimet/kuotimet e Bonove të Thesarit luhaten në varësi të situatës së likuiditetit në treg.

Shembull:

Një klient dëshiron të shesë një Bono Thesari në një shumë LEK 1,000,000 nga portofoli i Fibank të cilës i kanë mbetur 105 ditë deri në maturim.

Yield-i i blerjes nga Fibank është 7.0%.

Çmimi i blerjes = $1,000,000 * C / (7.0 + C)$

C - konstante e cila llogaritet $365 * 100 / 105$

Çmimi = $(1,000,000 * 348) / (7.0 + 348) = 980,260.5$

3. FIBank tregton Obligacione Thesari nga disa ankande me afate maturimi të ndryshme.

Për këtë shërbim nuk merret komision.

Obligacionet e thesarit blihen/shiten me *premium* ose *discount* ndaj vlerës së tyre nominale.

Kuotimet e Obligacioneve të Thesarit luhaten në varësi të tregut.

Kur klienti blen Obligacione Thesari, në ditën e blerjes paguan çmimin e blerjes në përputhje me vlerën nominale dhe Yield-in, i cili përcaktohet nga banka.

Kuotimet e Obligacioneve të Thesarit luhaten në varesi të tregut.